

Jeremy Henzell-Thomas

FUQIA E ARSIMIT





FUQIA E ARSIMIT

Jeremy Henzell-Thomas
Fuqia e Arsimit (Albanian)

Titulli origjinal
The Power of Education, The International Institute of Islamic Thought, 2018

Copyright © 2018 The International Institute of Islamic Thought, Herndon

Botimi i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2020 The International Institute of Islamic Thought, Herndon

Ky libër është e drejtë e autorit. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe në dispozitat e marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, asnjë riprodhim i asnjë pjese nuk mund të bëhet pa lejen me shkrim të botuesve.

PËRKTHIMI: Astrit Hykaj

BOTUES: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, www.aiitc.net

REDAKTIMI SHKENCOR: Ardian Muhaj

KORREKTIMI LETRAR: Oriola Sula

REDAKTOR TEKNIK: Suhejb Xhemali

SHTYPI NGA: Shtypshkronja dhe Shtëpia Botuese 'Mileniumi i Ri',

Autostrada Tiranë - Durrës, km 26, Cel: +355 672063702,

Email: info@milenumiri.al, web: www.milenumiri.al

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Henzell-Thomas, Jeremy
Fuqia e arsimit / Jeremy Henzell-Thomas ; përkth. Astrit Hykaj. -
Tiranë : Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, 2020
45 f. ; 21 cm.

Tit. origj.: The power of education

ISBN 978-9928-126-30-6

1.Arsimi 2.Edukimi moral 3.Vlera sociale

37
2 -47

Jeremy Henzell-Thomas



FUQIA E ARSIMIT

Përkthimi:
Astrit Hykaj



Tiranë, 2020



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i
Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	7
SOKRATI DHE FUQIA E TË PYETURIT	11
KËRKIMI I HAPUR DHE MËSIMI PËRGJATË JETËS.....	16
TËRËSIA, COPËZIMI DHE VETËNDRYSHIMI.....	18
ZGJERIMI I HORIZONTIT TË DIJES NJERËZORE.....	20
HAPJA DREJT TEJLËNDORES.....	23
SHUMËLLOJSHMËRIA DHE GJALLËRIA E TEJSKAJSHME	25
RREGULLIMI I SHKOLLIMIT	29
MËSIMET E GABUARA - MENDËSITË E KUSHTËZUARA - DYZIMET-KEQPERCEPTIMET	33
PËRMBUSHJA E AFTËSIVE NJERËZORE	37
PËRSOSMËRI PËRMES SHPIRTIT	39



PARATHËNIE

Nisma *Përparimi i Arsimit në Shoqëritë Muslimane (AEMS)*, lindi si pasojë e njohjes së shumë mangësive e sfidave, me të cilat arsimi përballet në ditët e sotme. Pas takimeve të njëpasnjëshme, në bashkëpunim me qendrën “Wilson”, në datat 9-10 dhjetor 2013, në Uashington u mbajt takimi dyditor me temë: “Reforma e arsimit të lartë në shoqëritë muslimane”. Takime të tjera të rëndësishme u zhvilluan më pas, në vitin 2014, në Britaninë e Madhe, të mbajtura nga Zyra e IIIT në Londër, të cilat çuan në botimin e dy punimeve shkencore të rëndësishme nga Profesor Abdelwahab El-Affendi dhe Dr. Jeremy Henzell-Thomas. Më vonë, këto punime u ndërthurën në një punim të vetëm nga Profesor Ziauddin Sardar, me titull: “Nga Islamizimi tek integrimi i njohurive: Rimendimi i reformës në arsimin e lartë”. Një takim i dytë, me titull “Reforma e arsimit në shoqëritë muslimane”, u mbajt në Turqi, në datat 18-19 mars 2016, organizuar nga Fakulteti i Teologjisë, në Universitetin e Stambollit, në bashkëpunim me MAHAY. Një numër tryezash të rrumbullakëta pune janë mbajtur për këtë çështje, gjatë viteve 2015-2017, në Londër, Stamboll, Konja, Uashington, Bruksel, Cape Town e gjetkë.

Rimendimi i Reformës në Arsimin e Lartë, nga Ziauddin Sardar dhe Jeremy Henzell-Thomas, u botua në vitin 2017, si pjesë

e botimeve në seri nga AEMS, i ndjekur nga një tjetër botim, në vitin 2018, si përmbledhje e shkurtuar. *Leximet e kohëve pasnormale*, pikëpamjet e të cilit përqendrohen në arsim, po botohet në bashkëpunim me Qendrën për Politikën e Studimeve të së Ardhmes. Një tjetër hulumtim me temë: *Mësimi i fëmijëve – një këndvështrim moral, shpirtëror dhe tërësor në përparimin arsimor*, nga Ann El-Moslimany, është në botim e sipër.

Një mendje e arsimuar, është një mendje e fuqishme, nga ku buron edhe arsyeja e titullimit të këtij punimi “Fuqia e Arsimit”. Kështu që natyra dhe veçoritë e këtij arsimimi kanë një rëndësi përtej përfitimit të njohurive, për hir të njohurive. Me fjalë të tjera, arsimimi në thelb është më shumë se thjesht një zhvillim mendor, pasi e zbukuron shoqërinë.

Ai i hap rrugën shumë dukurive që ndikojnë në të ardhmen e shoqërisë, individit dhe të mbarë njerëzimit në përgjithësi. Kjo është dhe arsyeja që arsimi shndërrohet në një fushë jetësore, për sa i përket rimendimit të vazhdueshëm, rijetësimit dhe zhvillimit.

Duke zbuluar këto pjesë përbërëse, nisma e AEMS synon t’u japë vlerë dhe përmbajtje zhvillimeve mendore si dhe ta lartësojë marrjen e diturive, përtej mënyrës pasive dhe mësimëve sipas rregullave të caktuara, drejt kërkesave të cilat synojnë më të mirën, qoftë nga ana vetjake, qoftë për mbarë njerëzimin. Një përpjekje e tillë, detyrimisht çon në marrjen parasysh të shumë pikëpamjeve në lidhje me arsimin, pa harruar vetarsimimin, si më të rëndësishmin nga të gjithë. Ajo çfarë ka rëndësi thelbësore, është riparimi i moralit, vlerave dhe parimeve të gjithësisë, si dhe jetësimi i një mënyre jetese gjithnjë e më shumë e përqendruar te të mirat materiale dhe përparimi vetjak, si qëllimi kryesor i gjithçkaje të mësuar dhe të përcaktuar si e vlefshme. Është e rëndësishme t’u bëhet me dije studentëve rëndësia e vlerësimit dhe e mirëkuptimit të faktit se sa madhështor dhe bujar është, në të vërtetë, qëllimi i arsimimit, të ngjallë tek ata një rishikim të

moralshëm të respektit të ndërsjellë, të përgjegjësisë shoqërore dhe mëshirës. Kjo mund të kërkojë një rimendim të rregullave të qenësishme dhe rizbulimin e rregullave të reja, si dhe një punë të lidhur ngushtë me njohuritë dhe ligjërimet e deritanishme, duke marrë parasysh rregullat morale dhe sjelljet e shoqërisë. Gjithashtu, do kërkojë rishikimin e udhërrëfyesit të parimeve mbi të cilat veprohet, ndërtimin e themeleve të ngrehinës shoqërore dhe veçorisë shpirtërore.

Në vend të një këndvështrimi dritëshkurtër dhe përjashtues, AEMS e pranon ndashmërinë dhe shumëllojshmërinë e rrjetit ndërveprues bashkëkohor mbarëbotëror dhe ka për qëllim zëvendësimin e qasjeve të njëanshme, duke ndjerë të nevojshëm kuptimin, në mënyrë më krijuese dhe të zgjeruar, të vërtetësisë jetësore, e cila në vende të ndryshme dhe tradita të ndryshme përjetohet në mënyra të ndryshme. Ky punim shkencor është botuar për herë të parë në numrin 14 “Power”, të revistës *Critical Muslim*, prill-qershor 2015. Megjithëse mendimet dhe idetë e paraqitura i përkasin autorit, ai është botuar si pjesë e projektit AEMS, si një punë në shqyrtim të vazhdueshëm, me qëllim nxitjen e mendimeve mbi gjithëpërfshirjen dhe çështjet e tjera të ngritura aty.¹

1 Në lidhje me arsimin, kam kristalizuar aty-këtu ide të ndryshme, të shprehura në punimet e mia të tjera shkencore, duke përfshirë si vijon: *Foreword to Zahra Al Zeera, Wholeness and Holiness in Education: An Islamic Perspective* (Richmond: International Institute for Islamic Thought, 2001); *Passing Between the Clashing Rocks: The Heroic Quest for a Common and Inclusive Identity*, *The Journal of Pastoral Care in Education*, 22:3 (2004), fq. 35-44; *Thinking Skills: Engaging the Intellect Holistically*, *Islamica*, Issue 15 (2005); *Thinking Outside the Box*, *Islamica*, Issue 16 (2006); *Key Elements of Holistic Education*, *Islamica*, Issue 17 (2006); *Muslim Youth and the Renewal of Core Human Values: The Centrality of Education*, AMSS Conference, *Muslim Youth: Challenges, Opportunities and Expectations*, University of Chester, 2009; *Islam and Human Excellence*, referimi kryesor Goldman Sachs Eid event, London, 3 shtator 2010; *Islamic Education: Cosy Corner, Lame Duck, Model of Compliance, or Beacon of Excellence?*, in *Contextualising Islam in Britain II*, a report compiled (with Professor Yasir Suleiman) for DCLG (University of Cambridge, 2012).



SOKRATI DHE FUQIA E TË PYETURIT

Ndërkohë që po shkruaja këtë punim shkencor, për herë të parë në mbarë botën u botua në ballinën e gazetës “*The Times*”, njoftimi se Muzeu Britanik kishte lejuar që të dilnin nga Londra për herë të parë, pjesë të skulpturave të Panteonit për t’i huazuar në Muzeun e Eremiteve të Shën Pjetërburgut.² Shkrime të tjera, njëra pas tjetrës, në faqet e gazetës zbulonin ndikimet e shfaqjes së kësaj veprë arti në muzeun e themeluar më 1764, nga Katerina e Madhe, për t’i dhënë mundësi Rusisë të bëhej pjesë e Rilindjes Europiane. Sigurisht që vendi i shpalesjes është tepër simbolik, në një kohë kur dita-ditës po rritet frika e një lufte të re të ftohtë midis Kremlinit dhe Perëndimit. Neil Mc. Gregor, drejtori i Muzeut Britanik, beson vërtetë se marrëdhëniet midis muzeve janë një shembull i fuqisë së kulturës në ndërtimin e urave mes kombeve. Aq më tepër, në kohë tensionimi e krisjesh politike.

Një skulpturë në trajtë perëndie, e huazuar në Muzeun e Shën Pjetërburgut, mendohet të përfaqësojë lumin Ilisos, një nga buriemet që në lashtësi rridhte pranë Athinës. Sipas Platonit, siç e përkruan Mc. Gregor, këtu ishte vendi ku: “Sokrati bisedoi me Fedrën,

2 Lajmi i huazimit të Mermerëve Elgin nga Muzeu Hermitage, doli në *The Times*, më 2014/12/5.

nën hijet e freskëta të pemëve, të rritura përgjatë bregut të lumit, duke shqyrtuar vlerën e bukurisë dhe moralitetin e dashurisë”. Si e tillë, ajo bisedë “mishëron vlerat qendrore të bashkëbisedimit dhe qasjes, të cilat nënvizojnë edhe sot idealet e mendjeve kureshtarë dhe lirinë politike” dhe kjo është “një shenjë shprehëse e vlerave kyçe të të dyjave, Athinës së Lashtë dhe Rilindjes Europiane”.

Unë nuk kam për qëllim të zhvlerësoj apo të hedh në erë parimin thelbësor të Mc. Gregor për shenjtërinë e qasjes së mendimeve mbi të vërtetën. Përkundrazi, dua ta marr atë si një formulë të vërtetë dhe themelore, në lidhje me ato që do të them rreth fuqisë së arsimimit. Megjithatë, është mirë të mbahet mend, se Sokrati u dënua me vdekje, sipas Platonit, ngaqë ishte “njeriu i mërzitshëm” për shtetin, ngacmuesi që pickon kalin në ecje e sipër, “ferra në mish” etj. Më është kujtuar përcaktimi i hapjes së punës shkencore të Ziauddin Sardar në botimin e fundit të revistës *Critical Muslim*, në lidhje me rrezikun e “mendimit të lirë”.³

Ai shkruan: “Mendimtarët e lirë shihen si të rrezikshëm, thjesht sepse mendimi i lirë sfidon mendimin tradicional e zakonor, si dhe këndvështrimin mbizotërues. Mënjanimi apo përjashtimi, – vazhdon ai, - janë pasoja jo dhe aq të befasishme, që bien mbi ata që sfidojnë. Në rastin e Sokratit, qytetarët e spikatur të Athinës u bënë të dukeshin të cekët, përballë zgjuarsisë së tij vetëkundërshtuese në pamje të jashtme. Një nga mëkatet e tij kryesore, si filozof kritik, social e moral, u gjykua të ishte mungesa e besimit (mosbesimi në “perënditë” e shtetit). Mirëpo duhet ta mbajmë mend gjithmonë, që Sokrati nuk ishte një ngatërrestar i vetënxitur a i mahnitur nga zgjuarsia dhe dituria e tij, apo nga paqartësia krijuese dhe thelbësore e mendjehollësisë së tij. Dhe as nuk e kishte kthyer mendimin e lirë në vetvete, në një farë lloj ideologjie fetare, përmes së cilës të fshihte të ashtuquajturat

3 Studimi nga Ziauddin Sardar në mendimin e lirë është: “The Circumference of Free Thought”, *Critical Muslim (Dangerous Freethinkers)*, October-December 2014, fq. 3-14.

mendime “përparimtare”, në kundërshtim me besimin fetar dhe ‘bestytnitë’. Nëse ai do të ishte mes nesh sot, nuk do ta shikonim si përkrahës dhe servil të gjunjëzuar, përballë fitores së “vlerave të Rilindjes”, “shtetit laik”, “materializmit shkencor”, apo çfarë-dolloj fundamentalizmi tjetër, qoftë laik apo fetar.

Gjithashtu, Sokrati do kishte qenë njeriu i fundit që të lëvdohej me vetëpëlqimin e figurës së vet. Ai jo vetëm që nuk kishte as edhe më të voglën kërshtëri për të qenë njeri me famë, por gjithashtu e pranonte thellësinë e padijes së vet. Siç e pranon edhe Sardar: “I dituri e di që përlësia është një kusht paraprak për të kuptuar vërtetë”. Ajo çfarë i bëri të mos ndjeheshin mirë të spikaturit e Athinës, ishte mënyra me të cilën Sokrati arsyetoi shpalljen e orakullit të Delfit. I pyetur, nëse ka më të mençur se Sokrati, orakulli u përgjigj se askush nuk ishte më i mençur se ai. Ngaqë Sokrati besonte se nuk zotëronte kurrfarë zgjuarsie, ai e interpretoi këtë si absurde dhe vazhdoi ta vinte në provë gjëgjëzën (me qëllim që ta hidhte poshtë), duke vënë në pikëpyetje mençurinë në përgjithësi të qytetarëve të zgjedhur të Athinës. Ai doli në përfundimin se, ndërkohë që njerëzit e ashtuquajtur të mençur e mendojnë veten e tyre si të mençur, kur nuk janë, ai vetë e dinte se nuk ishte aspak i mençur dhe kjo, në mënyrë paradoksale, e bëri më të mençurin, ngaqë ishte i vetmi i vetëdijshëm, në lidhje me padijen e tij. Ai e kuptoi se orakulli kishte pasur të drejtë.

Apologjia e Platonit përshkruan mbrojtjen e Sokratit para 500 gjyqtarëve, me një gojëtar të pashembullt.⁴ Kjo “mbrojtje” nuk është aspak një shfaqësim, por, sipas Russell Bosworth, një pranim tronditës i “meritave të një jete me vetëdije, të përkushtuar ndaj kujdesit të shpirtit, zbulimit të mençurisë dhe besnikërisë ndaj të vërtetës”.⁵

4 *Apologjia e Platonit*, përkthyer nga Benjamin Jowett, mund të lexohet në: <http://classics.mit.edu/Plato/apology.html>.

5 Disa pasqyrime të përmbledhura nga Russell Bosworth, lidhur me trashëgiminë kulturore të Sokratit, mund të gjenden në: <http://www.philosophyworks.org/content/lives-plato-and-socrates> (accessed 8/12/14).

Thomas Merton, një ëndërrimtar dhe kristian me ndikim të madh, pjesëmarrës politik, largpamës dhe njeri i letrave, shkruan me një thellësi të adhurueshme, mbi ndërjegjësimin mendor e vetjak të nevojës së mishërimit të asaj që dimë dhe të asaj që mendojmë në drejtimin e jetëve tona: “Veprimtaria e duhur e njeriut nuk është dëlirësisht mendore, ngaqë njeriu nuk është thjesht një mendje e shkëputur nga trupi. Fati ynë e përcakton që ne të jetojmë atë që mendojmë, sepse, po nuk jetuam atë që dimë, as që do ta dinim se cili do të ishte fati ynë”.⁶ Nëse kërkon në Google: “Fuqia e Arsimit”, një nga dhjetë shkrimet e para, nga rreth gjysmë miliard shkrime, është ai i *Deutsche Welle*, i cili na tregon se: “Arsimim do të thotë më shumë sesa të marrësh njohuri. Arsimi fuqizon njerëzit për të zhvilluar personalitetin dhe për të qenë politikisht të përfshirë. Kjo nuk është gjithmonë në interesin e sundimtarëve...” *Deutsche Welle* vazhdon, duke thënë se: “Arsimimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe një fuqi çliruese për zhvillimet politike, demokracinë dhe drejtësinë shoqërore, që fuqizon njerëzit për të diskutuar rreth teprimeve dhe keqpërdorimit të pushtetit nga sundimtarët dhe qeveritarët, si dhe për të fituar të drejtën mbi përfytyrimin e së ardhmes së pashtrembëruar.”⁷

Çelësi i kësaj është ballafaqimi i zhvillimeve vetjake me qëndrueshmërinë, kundrejt përpjekjes për t’i detyruar njerëzit t’i binden shtetit, si dhe veprimtarinë për liri e drejtësi shoqërore. Kurani e bën të qartë, se ndryshimi i shoqërisë dhe botës në përgjithësi, duhet bërë mbi të gjitha në lidhje me ndryshimet vetjake: “Zoti nuk i ndryshon rrethanat e njeriut, nëse ato nuk ndryshojnë brenda vetes” (13:11). Thuhet se Profeti Muhamed (a.s.)

6 Përshtypjet e Thomas Merton mbi nevojën e të “jetuarit çfarë mendojmë”, janë pasqyruar në librin e tij: *Thoughts in Solitude* (Farrar Straus Giroux, 1993) dhe *Seeds*, përzgjedhur dhe redaktuar nga Robert Inchausti (Boston, MA: Shambhala Publications, Inc., 2002), fq. 131.

7 Shkrimi nga *Deutsche Welle* titullohet: “Knowledge is Power: Why Education Matters” dhe doli më 4/12/14, në: <http://www.dw.de/knowledge-is-powerwhy-education-matters/a-15880356>.

ka thënë: “Ai që njuh vetveten, njuh Zotin”, gjithashtu (por jo e përfshirë në përmbledhjet e haditheve të *besueshme*) thuhet se ai e ka përshkruar luftën e shenjtë (*al-jihad al-akbar*), si një luftë të dikujt kundër përlësisë brenda vetvetes. Fjala e urtë e lashtësisë “Njih vetveten” (*gnothi se auton*), ishte një nga parimet e Delfit, e gdhendur në muret e oborrit përpara tempullit të Apollonit, si dhe një nga rregullat udhërrëfyese të Akademisë së Platonit

Merton tërheq vëmendjen mbi rrezikun e ndryshimeve politike me përmbysje, i cili nuk është i rrënjosur në vetëdijen dhe vetëndryshimin: “Ata që përpiqen të veprojnë dhe të bëjnë gjëra për të tjerët, apo për botën në përgjithësi, pa u thelluar në të kuptuarit e lirisë, ndershmërisë dhe fuqisë së dashurisë brenda vetvetes, nuk do të kenë asgjë për t’u dhënë të tjerëve. Ata do mbarin te të tjerët asgjë më tepër sesa sëmundjen ngjitëse të fiksimeve personale, tërbimin e tyre, qëllimet egoiste, mashtrimet e tyre rreth qëllimit e mjetit, si dhe shkollat apo mendimet paragjyquese të tyre”. Një nga thëniet e Nelson Mandelës, ishte tepër popullore në internet, e cila thoshte pak a shumë: “Arsimimi është arma më e fuqishme, të cilën mund ta përdorësh për të ndryshuar botën”. Një tjetër thënie shumë e lexuar theksonte fuqinë që ka arsimit për “të ndryshuar pikëpamjen e dikujt rreth botës dhe si të jetosh jetën e tjetrit”, apo të tjera thënie që sqarojnë se si “fuqia e ndryshimit që ka një arsim i përkryer, mund të ndryshojë gjithçka”. Tashmë burimet që përftohen nga kërkimet në internet, janë të mbushura me thënie shpesh të nxjerra nga përmbajtja dhe të zvogëluara në më pak sesa shprehje të tejpërdorura, pafundësisht të përsëritura dhe të rifuqizuara, përgjatë faqeve pafund. Sapo diçka t’i vishet dikujt, në internet synohet të përhapet pafundësisht si e vërteta e Ungjillit. Kjo sigurisht që është një nga të metat e mënyrës së të mësuarit në çast, e cila, pa marrë parasysh vlerën e paçmuar të aksesit të menjëhershëm drejt dijes që ofron, gjithashtu mund t’u japë përparësi të vërtetave të

rëndomta dhe të përsëritura, parullave, banaliteteve dhe zërave që tingëllojnë të rëndësishëm. Gjithashtu, mund të çimentojë popullaritetin në përmbledhje thëniesh, përmes një sistemi vlerësimi vetëpërbushës, i bazuar në numrin e shikueshmërisë. Sidoqoftë, do të ishte gabim të bënim lojëra fjalësh me mendimin që përshkruan thelbin e shumicës së parimeve të hasura në shprehjet më të lexuara, të cilat mbështesin idenë e thjeshtë, por të një rëndësie madhështore – arsimi ka fuqinë të ndryshojë jo vetëm dikë, por mbarë botën.

Rrënja indo – europiane *poti*, prej së cilës rrjedh fjala latine *potere* (me qenë në gjendje) është burimi i fjalës angleze *power* *potent*, *potential*, *possibility* (fuqi, i fuqishëm, i mundshëm, mundësi), si dhe burimi i fjalës sanskrite *patih* - mjeshtër. Të bëhesh mjeshtër i vetvetes ndihmon (të jep fuqi) t’u shërbesh të tjerëve. Parësore dhe mbi të gjitha, arsimimi më i mirë duhet të pranojë fuqinë e provimit, njohjen dhe ndryshimin e vetvetes, me qëllim që të ndryshojmë jetën e të tjerëve.

KËRKIMI I HAPUR DHE MËSIMI PËRGJATË JETËS

Ky ndryshim është gjithashtu një udhëtim i pafund i kërkimit të hapur dhe mësimi përgjatë gjithë jetës, i rrënosur në kushtin paraprak, se dija nuk ka fund. Kjo, sigurisht, është e vërtetë jo vetëm në rrafshin mendor, por edhe në shtegtimin shpirtëror. Me çdo hap të ndërmarrë drejt zgjerimit të kuptimit mbi të vërtetën, shtigje të reja shpalosen në të gjitha drejtimet, ngaqë e tillë është fuqia e pafundme prodhuese e Krijuesit. Një shije e tillë sjell siguri gjithnjë e më të madhe (*yaqîn*), por ironikisht sjell njëkohësisht hutim, ngaqë siguria shpirtërore nuk është e njëjtë me sigurinë e rreme të mendjeve të mbyllura, në kuptimin e tyre

të ngushtë, rreth lëndëve të pahulumtuara ndonjëherë. Një krahasim tundues i vazhdimësisë së pafund të arsimit mund të gjendet në përshkrimin e hutimit (*hayra*) në gjendje hyjnore të Ibn Arabit, që del nga dyert e zemrës përmes saj, duke grumbulluar vazhdimisht “vetë-shfaqjen”.⁸ Këtu ai përshkruan se si ndërgjegjësimi i dikujt mbi shpalljet e trajtës apo veprimtarisë së Zotit në botë, është zbulimi i ndërlikimeve të reja që shpalsen vazhdimisht. Nëpërmjet kësaj, njeriu, më në fund, e kupton në botën brenda vetes, se “kjo punë nuk ka një fund ku të ndalojë”. Kurani na tregon se: “edhe sikur të gjithë drurët e botës të ishin pendë dhe deti të ishte bojë, edhe po të shtojë shtatë dete të tjera, fjalët e Zotit nuk do shteronin...” (31-27). Ne mund të gjejmë një krahasim të pjesshëm të vazhdimësisë së “shpalljes”, nëse hapim folezat kineze në formë kutie, të trashëguara nga *Dera Song*, në të cilat janë vendosur njëra pas tjetrës kutitë më të vogla, brenda kutive më të mëdha. Më e vogla dhe e fundit e këtyre kutive (pararendës të folezave më vonë në trajtë kukulle nga japonezët dhe të njohura botërisht si *matryoshka* ruse), zakonisht përmban një kokërr të vetme orizi. Sigurisht që ka një kufi përfundimtar në hapjen dhe zbulimin e kutisë apo kukullës më të vogël, e cila prodhohet në mënyrë të tillë, që të futet brenda kutisë (duke marrë parasysh kufizimet fizike të lëndës dhe hapësirës). Mirëpo, nëse e vazhdojmë krahasimin më tutje, mund ta përjasim kokërrën e vetme të orizit në kutinë e fundit, si veçori e cila është thelbi, zanafilla e pikës pa përmasa, nga e cila zënë fill të gjitha kutitë që zmadhohen dhe prej së cilës “kjo punë nuk ka një fund tek i cili mund të ndalojë”. Arsimimi duhet të mundësojë fuqinë për të vazhduar hulumtimin dhe të mësuarit pa fund.

8 Pikëpamjet e Ibn Arabit mbi shpalsjen e vazhdueshme të nënkuptimeve, janë marrë nga kapitulli: *Al-Futuhat al-Makkiyyah*, vetëm pjesa mbi “*The people of spiritual bewilderment*” (*hayra*), përkthyer nga James Winston Morris, në librin *The Reflective Heart: Discovering Spiritual Intelligence in Ibn Arabi's Meccan Illuminations* (Louisville: Fons Vitae, 2005), fq. 81.

TËRËSIA, COPËZIMI DHE VETËNDRYSHIMI

Fizikani David Bom, i cilësuar nga Ajnshtajni si pasardhësi i tij, përkufizoi atë që e quajti “rregulli i ngatërrimit”, si një tërësi themelore dhe e pandarë, trajta fizike e së cilës vazhdimisht shpalo- set për jashtë dhe pastaj paloset për brenda, në mënyrë të tillë që “çdo pjesë e gjithësisë është në marrëdhënie me çdo pjesë tjetër”.⁹ Ky është përfytyrimi i plotë në tri përmasa i William Blake, “i të parit të botës në një kokërr gruri”, i cili nuk është thjesht një përfytyrim poetik i zbukuruar. Bashkimi dhe ndërlidhja e të gjitha gjërave është gjithashtu në zemër të zbulimit të John Stewart Bell. Ai tregoi se çdo grimcë në Gjithësi ka kuptimin e çdo grimce tjetër, ngaqë të gjitha kanë qenë të ndërthurura brenda veçorisë (kokrra e orizit). Shumëllojshmëria e formave është e pafund dhe në ndryshim e sipër, ashtu sikundër ka një thelb të pandryshueshëm, i cili përbën burimin e çdo gjëje si dhe pikën tonë hyrëse dhe dalëse, “dhe nga çdo gjë, ne kemi krijuar palë”, thotë Kurani (51:49), megjithatë, në shumëllojshmëri gjendet bashkimi.

Bonham e drejton vëmendjen te problemi i ngutshëm, shkak- tuar nga trajta e copëzuar e mendimit, e cila nuk mund të shohë bashkimin dhe lidhjen themelore. Kjo mënyrë prodhon rrëmujë dhe përplasje të pakuptimta, si dhe një varg të gjatë krizash: shoqërore, politike, ekonomike, mjedisore e mendore, si nga ana vetjake, ashtu dhe nga ana shoqërore në tërësi. Copëzimi për të cilin ankohet Bonham, vetëm sa është shtuar, që nga koha e botimit të librit të tij, në vitin 1980. Të mos harrojmë se Bonham mund të ki- shte përfshirë këtu edhe përplasjet fetare dhe ksenofobinë. Sot nuk është e nevojshme të shohim shumë larg nëpër botë, për të vërejtur molisjen, madje dhe pasojat shkatërrimtare të të menduarit në mënyrë fisnore, përjashtuese, ngadhënjyese si dhe politikave të ngjashmërive të ngushta, të cilat çojnë drejt papërshtatshmërisë

9 *Teoria e fizikës kuantike* nga David Bohm, është e parashtruar në librin e tij: *Wholeness and the Implicate Order* (London: Routledge, 1980).

dhe shtrembërimin të shkollave dhe vlerave kulturore, racore, fetare e kombëtare, apo në krijimin e epërsive qytetëruese, qoftë në Lindje, qoftë në Perëndim. Bashkimi në shumëllojshmëri është njëtrajtshmëri, aq sa ç'është barazimi me shkatërrimin e së përkryerës, e cila prish gjithë përmbajtjen.

Ibn Khaldun përdor shprehjen *asaabiyah* (partishmëri fisnore, etnocentrizëm) qoftë në kuptimin e mirë, qoftë në kuptimin e keq të fjalës.¹⁰ Ajo mund të jetë burim mbështetjeje, apo tërheqje të dyanshme mbarë shoqërore. Mirëpo mbart në vetvete një lloj vrazhdësie sipërfaqësore dhe mënyre të menduari, të fshehur brenda kulturës së vet, duke miratuar paragjykitime fisnore, mendjengushtësi dhe interesa vetjake. Reagimi i Pejgamberit (a.s.) në lidhje me mburrjen e lavdisë stërgjyshore, kishte si qëllim të paralajmëronte ata që janë zhytur në mendjemadhësinë e padijes pagane paraislame (*jahiliyyah*), se Islami e ka shfuqizuar mendësinë fisnore dhe se të gjitha qeniet njerëzore janë pasardhës të Adamit.¹¹ Ne na këshillon Kurani (49:13), se nuk ka epërsi të njërit mbi tjetrin, përveç *taqwa*, përveç vetëdijes dhe dashurisë së frikshme për Zotin, e cila na frymëzon të jemi vazhdimisht syçelur dhe të bëjmë atë që është e drejtë. Ky varg shpreh një dënim të nënkuptuar të të gjitha paragjykitimeve folklorike, racore, shoqërore, kombëtare, fisnore, dënim i bërë qartë nga Profeti Muhamed (a.s.): “Ai që shpreh çështje partishmërie fisnore, nuk është nga ne, dhe as ai që vdes për çështje fisnore”. Kur e pyetën se çfarë nënkuptonte me partishmëri fisnore, Profeti (a.s.) u përgjigj: “Nënkuptoj të ndihmohesh njerëzit e tu në një çështje të padrejtë”.

Mosmiratimi i mendësisë fisnore është gjithashtu i lidhur ngushtë me Marrëveshjen e të Virtytshmit (*hilf al-fudul*), që u arrit kur Muhamedi (a.s.) ishte i ri, para se të bëhej Profet. Në

10 Pikëpamjet e Ibn Khaldunit rreth *asabijes*, janë shqyrtuar në: Asyiqin Abdul Halim et al., “Ibn Khaldun’s Theory of ‘Asabiyyah and its Application in Modern Muslim Society”, *Middle-East Journal of Scientific Research*, 11:9 (2012), fq. 1232-1237.

11 Hadithet e Pejgamberit mbi *asabijen* janë marrë nga Muhammad Asad, në komentimin e tij të Kuranit, 28:15 dhe 49:13.

këtë marrëveshje, udhëheqësit fisnorë, anëtarë të fiseve, u zotuan se ishte detyra e tyre e përbashkët të ndërhyjnë në ngatërresat, lidhur me çështjet e drejtësisë, duke mbajtur anën e të shtypurve kundër shtypësve, kushdo qofshin ata dhe çfarëdo lloj marrëveshjeje që mund t'i bashkonte ata me fiset e tjera. Miratimi i kësaj marrëveshjeje nga Profeti (a.s.), i cili nuk pa asgjë në kundërshtim me vlerat islame, vërteton parimet e drejtësisë, moralit dhe të mirës së përbashkët shoqërore, e cila nuk është e drejtë e veçantë e asnjë bashkësie, besimi apo ideologjie. Arsimi duhet të nxisë fuqinë e pezullimit të mendimit të copëzuar, zgjidhjen e ngatërresave dhe të kapërcejë përkufizimet e ngushta lidhur me identitetin.

ZGJERIMI I HORIZONTIT TË DIJES NJERËZORE

Më kujtohet kur isha fëmijë dymbëdhjetë vjeç, se si merrja hua një teleskop të përthyeshem pesë centimetra, nga biblioteka e lagjes dhe për gjashtë muaj rresht skicoja qiellin natën. Besoj se prindërit e mi ishin të lumtur me detyrën madhështore që i kisha vënë vetes, e cila së paku do më mbante larg punëve të liga. Më kujtohet frika dhe kënaqësia që ndjeva, kur Saturni pluskoi përpara syve të mi. Munda të shihja me qartësi tri unazat kryesore, përmes teleskopit tim amator. Një teleskop i fuqishëm mund të shquajë mbi tetë unaza dhe anijet kozmike si Cassini, tashmë mund të mundësojnë të shohësh tridhjetë unaza të Saturnit dhe hapësirat midis tyre. Numri i saktë i unazave është ende i panjohur. Siç e tregon edhe zbulimi i unazave të reja, dija njerëzore përparon e zgjerohet. Një nga parakushtet më të rëndësishme në zgjerimin e saj, është vlera e paçmuar e shumëllojshmërisë së mendimeve, shkëmbimet dhe takimet ndërkulturore. Ahmed Moustafa dhe Stefan Sperl tregojnë në veprën e tyre madhore të kohëve të fundit, përmes gjeometrisë së

shenjtë dhe shkencës arabe të kaligrafisë, se duhej të kalonin tri shekuj, pas vdekjes së Profetit të Islamit, përpara se të shpikkej lloji i shkrimit të përshkallëzuar nga veziri abasid, Ibn Muqla, dhe mjeshtri i shkrimit, Ibn al-Bawwab, në Bagdadin e shekullit X. Kjo ndodhi ngaqë horizonti që përfshinte njohuritë e kulturës islame (duke përfshirë terminologjinë shkencore në gjuhën arabe), duhej të zgjerohej mjaftueshëm, për të përfshirë dhe përvetësuar përparimet e qytetërimeve të tjera më të hershme.¹² Gjithë kjo rritje e vetëdijes në vazhdimësi këshillohet në vargjet e Kuranit: “Ne do ua tregojmë shenjat Tona në horizontet më të largëta të gjithësisë dhe brenda shpirtrave të tyre, me qëllim që të bëhet e qartë për ata, se kjo Shpallje është pa dyshim e vërteta” (41:53). Këtu, ashtu siç e kuptoj unë, fjala horizontet (*afaq*) ka lidhje me dy gjëra: zgjerimin e hapësirës dhe lartësimin e vetëdijes njerëzore, në varësi me fushat e ndryshme të dijes, cilido qoftë burimi i tyre. Vargjet e para të Kuranit na nxitin: “Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte” (96:3-5). Muhamed Asad dëfton se pena është shenja e gjithë diturisë, e mbajtur shënim në trajtën e shkruar, si dhe aftësia e veçantë e njeriut për të mbartur përmes shkrimeve mendimet, përvojat dhe njohuritë nga njëri te tjetri, brez pas brezi, nga një mjedis kulturor te tjetri, gjë e cila i jep gjithë dijes njerëzore veti grumbulluese.

Duhet të bëjmë shumë të qartë, se shkëmbimi kulturor në vazhdimësi është një punë plotësuese në shumë drejtime. Nëse qytetërimi islam ka huazuar shumë nga filozofia, sjellja morale dhe gjeometria greke e lashtësisë, ashtu dhe qytetërimi perëndimor i detyrohet asaj që Muhamed Asad, në mënyrë shprehëse, e përshkruan si këmbëngulja në “vetëdije dhe njohuri” që e përshkon Kuranin, gjë që ka sjellë: “epokën e shkëlqyer të dijeve dhe kërkimeve shkencore, e cila e hijeshoi botën islame në majat më

12 Studimi nga Ahmed Moustafa dhe Stefan Sperl gjendet në: *The Cosmic Script: Sacred Geometry and the Science of Arabic Penmanship* (London: Thames and Hudson, 2014).

të larta të vrullit të vet kulturor”.¹³ Një sërë librash të botuara kohët e fundit, kanë korrigjuar deri tani përhapjen e paragjykimit perëndimor, i cili, në mënyrë kërkimore, ka lënë pas dore ndihmesën e kulturave dhe qytetërimeve joperëndimore në zhvillimin e qytetërimit perëndimor.¹⁴

Siç e shpjegon edhe Asad, Kurani hapi rrugën në ngritjen e një kulture “hulumtimi të pavarur dhe kërkime intelektuale”, e cila “depërtoi në rrugë të pafundme, qoftë edhe ato dytësore, në mendjet e Europës mesjetare dhe hapi rrugën e rijetësimit të kulturës perëndimore, që njihet me emrin Rilindje. Kështu që në rrjedhën e kohës, ajo u bë përgjegjëse për lindjen e asaj që ne e quajmë Epoka e shkencës, koha në të cilën jetojmë sot”. Më erdhi ndër mend zhvlerësimi që shkrintari Sebastian Faulks i bën Kuranit si dhe kundërpërgjigja e këndshme e Ziauddin Sardar në *The Guardian*.¹⁵ Faulks e kishte përshkruar Kuranin (një temë për të cilën Sardar thekson: “është dukshëm përtej aftësisë së tij për ta kuptuar”) si “shumë zhgënjyes”, “njëpërmasor”, “shterp”, “libër dëshpërues”, “pa përmasa etike”. Siç thekson edhe Sardar, sikur të ishte ashtu, “si mund të nxisë besimtarët të zhvillojnë shkencën dhe mësimin, të përkrahin arsyen dhe metodën eksperimentale, të themelojë universitete dhe spitale me baza kërkimore si dhe kërkime të përparuara filozofike?”

13 Thëniet nga Muhammad Asad, në lidhje me ndikimet e Kuranit, rreth zhvillimit të qytetërimit perëndimor, janë marrë nga parathënia e tij në: *The Message of the Qur'an* (Bath: The Book Foundation, 2004), fq. vi. Thëniet e tjera nga Asad janë marrë nga përshtypjet e tij për këtë libër. Thëniet që unë kam nxjerrë nga Kurani, janë përkthimet e Asadit me ndonjë përmirësim.

14 Paragjykimet perëndimore janë hulumtuar shkencërisht nga Jack Goody në: *The Theft of History* (Cambridge University Press, 2006) dhe në *Renaissances: The One or the Many?* (Cambridge University Press, 2010). Gjithashtu, Jonathan Lyons, *The House of Wisdom: How the Arabs Transformed Western Civilization* (Bloomsbury, 2009) dhe John Hobson, *The Eastern Origins of Western Civilization* (Cambridge University Press, 2004).

15 Shkrimi i Ziauddin Sardarit në *The Guardian* rreth zhvlerësimit të Kuranit nga Sebastian Faulks, me titull: “Reading the Qur’an in the Dark” (27/8/09), doli në qarkullim më 2/9/14, në: <http://www.theguardian.com/commentisfree/belief/2009/aug/27/sebastian-faulksquran-islam>.

Arsimimi duhet të ketë fuqinë të dallojë dhe vlerësojë shumë burime dhe shtresa të dijes njerëzore dhe, përmes rrjedhave të tyre, të zhvillojë qytetërimin e njerëzve.

HAPJA DREJT TEJLËNDORES

Shtytja gjallëruese e përftuar nga Kurani ishte njëkohësisht shpirtërore dhe mendore. Qytetërimi që ai ushqeu, përfshiu mprehtësinë e së vërtetës, e cila, në nivelin më të lartë, është njohja e Zotit, ngaqë asnjë qytetërim i lartësuar nuk vlen të përmendet, nëse nuk mundet të bëjë dallimin midis kërshtërisë së çorientuar intelektuale (pa marrë parasysh sa “largpamës”, “i vërtetë” dhe “krijues”), dhe asaj vetie të përpjekjes intelektuale, që është e mbështetur në vlerat më të larta etike e shpirtërore, që në vetvete është një pasqyrim i tejëlëndores.

Duke pasur parasysh këtë, nuk mund të gjendet diçka më e përshtatshme sesa të sjell në mend fjalimin e Papa Françeskut në Parlamentin Europian, më 25 nëntor 2015, në Strasburg.¹⁶ Ai foli për muralen e famshme të Rafaelit, “Shkolla e Athinës”, në Vatikan. Aristoteli dhe Platoni janë në qendër: “Gishti i Platonit, - tha ai, - është i drejtuar lart, drejt botës së ideve, drejt qiellit, drejt parajsës, siç mund të themi ne. Aristoteli ka zgjatur dorën përpara tij, në drejtim të shikuesit, në drejtim të botës, vërtetësisë së ngurtë”. (Çfarë shëmbëllytre e mrekullueshme! – thashë me vete dhe më erdhi ndërmend një thënie e Profetit Muhamed (a.s.): “Unë kam dy anë, njëra e kthyer nga bota, tjetra nga Allahu”). Papa vazhdoi, duke thënë se muralja i ngjau “si një pasqyrim i përshtatshëm i Europës dhe historisë së saj, vazhdimisht e bërë si bashkëveprim midis tokës dhe qiellit, ku qielli na

16 Fjalimi i Papa Franciskos në Kuvendin Europian, më 25 nëntor, u nxor më 4/12/14, në <http://w2.vatican.va/content/francesco/en/speeches/>.

këshillon çiltërsi drejt mrekullisë – drejt Zotit – që gjithmonë ka shquar njerëzit e Europës, ndërkohë që toka përfaqëson aftësinë e ngurtë praktike të Europës për t'u përballur me rrethana e halle". Sa largpamës është përfundimi i tij, se e ardhmja e Europës varet në përmirësimin e lidhjeve jetësore midis këtyre dy pjesëve! "Një Europë e cila tashmë nuk është e hapur në përmirësimin e jetës, është një Europë e cila ngadalë rrezikon ta humbasë shpirtin e vet dhe shpirtin njerëzor, të cilin ende e do dhe e mbron".

Fjala e lashtë greke "*anthropos*" (qenie njerëzore), fare mirë mund ta ketë pasur kuptimin fillestar: "ai ose ajo që shikon lart në qiell".¹⁷ Qëndrimi ynë drejt na mundëson të shohim lart, atë qëllim më të lartë, i cili mbërrin përtej tokës, drejt qiellit dhe na vendos ne si një urë midis dy mbretërive. Ne kemi brenda vetes sonë, në natyrën tonë thelbësore, një sitë (*furqan*) apo një busull, e cila na drejton drejt zanafillës. Kjo sepse të dyja fjalët në anglisht, *orient* dhe *origin*, vijnë nga e njëjta rrënjë latine *oriri* - nisje dhe fjala "orient" fillimisht nënkuptonte "ktheje fytyrën nga lindja", në drejtim të lindjes së diellit, një gur prove që na tregon rrugën për të qenë plotësisht njerëz. Nëse Papa është peshkop, gjithë detyra e njerëzimit është e mishëruar në rrënjën e kësaj fjale latine "*pontifex* - urëndërtuesi ", ai që merret vesh me njerëzit dhe Zotin.

Arsimi duhet të japë fuqinë për t'u zgjatur drejt qiellit, bashkëngjitur tokës dhe parajsës, mrekullisë së brendshme, me dashuri për Zotin dhe "gjithçka që lëviz në faqe të dheut".

17 Për shumicën e hulumtimeve rreth prejardhjes së fjalëve, i detyrohem John Ayto, *Bloomsbury Dictionary of Word Origins* (London: Bloomsbury Publishing Limited, 1990), *Cassell's Dictionary of Word Histories* (London: Cassell, 2000), dhe *Chambers Dictionary of Etymology* (Edinburgh: Chambers, 1988).

SHUMËLLOJSHMËRIA DHE GJALLËRIA E TEJSKAJSHME

Shumë nga ne, tashmë e dimë përmbajtjen e tregimit të Biblës për Kullën e Babelit, nga *Libri i Zanafillës* (11:1-9). Madje edhe ata që se dinë, janë të njohur me përdorimin metaforik të fjalës “Babel”, që nënkupton çoroditje, çoroditje zërash, apo zhurma zërash të përzier me pakuptueshmëri të ndërsjellë. Sipas shkrimeve të Zanafillës, Kulla e Babelit u lartësua nga pasardhësit e Noas, në një përpjekje marramendëse për të mbërritur qiellin. Si ndëshkim për kryeneçësinë e tyre, Zoti i ngatërroi, duke e bërë të pamundur për punëtorët të merreshin vesh me njëri-tjetrin. Që nga ajo kohë, sipas gojëdhënës, filloi copëzimi i të folurës njerëzore në gjuhë të ndryshme të botës, si dhe përhapja e njerëzimit kudo në faqe të dheut.

Megjithatë, Kurani nuk e mbështet mendimin se ndarja e gjuhëve dhe racave është një ndëshkim apo barrë në shpinën e njerëzimit.¹⁸ Përkundrazi, përcakton bashkim në shumëllojshmëri, jo vetëm në këndvështrimin kulturor, gjuhësor e racor, por edhe në kuptimin fetar. Thjesht, shumëllojshmëria është një nga anët e *fitras*, trajta thelbësore e parakushtit të lashtë të qenieve njerëzore. Sipas Mahmoud Ayoub, shumëllojshmëria e njerëzimit “nuk është për shkak të venitjes së shoqërisë njerëzore nga një gjendje ideale apo ëndërrimtare, as mungesë udhërrëfimi hyjnor apo kuptimi nga njerëzit. Më saktë, shumëllojshmëria e besimeve është një rrethanë e zakonshme njerëzore. Ajo është pasojë e shumëllojshmërisë së kulturave, racave, gjuhëve të njerëzimit si dhe mjediseve të ndryshme”.¹⁹ “Shpallja, - shprehet rabini Abraham Heschel, - është gjithmonë në shërbim të strehimit të aftësive

18 Lidhur me shumëllojshmërinë e mbështetur te Kurani, shikoni: Reza Shah-Kazemi, *The Metaphysics of Interfaith Dialogue: Sufi Perspectives on the Universality of the Qur’anic Message*, në James Cutsinger (ed.), *Paths to the Heart: Sufism and the Christian East* (Bloomington, Indiana: World Wisdom, 2002).

19 Thëniet e Mahmoud Ayoubit janë marrë nga punimi i tij shkencor: *The Qur’an and Religious Pluralism*, në Roger Boase (ed.), *Islam and Global Dialogue, Religious Pluralism and the Pursuit of Peace* (Aldershot: Ashgate, 2005), fq. 273.

të njeriut. As dy mendje nuk janë njëlloj, ashtu sikurse dy fytyra nuk janë njëlloj. Zëri i Perëndisë mbërrin në shpirtin e njeriut në mënyra të ndryshme, në shumëllojshmërinë e gjuhëve”.²⁰ Gjithashtu, Nancy Kline është shumë e saktë, kur mbron mendimin se “Shumëllojshmëria rrit zgjuarsinë e grupeve”.²¹

Njëtrajtshmëria është një mënyrë mohimi. Kërkimet e fundit kanë treguar se një nga arsytet që çoi në zhdukjen e njeriut të Neandertalit, është paaftësia e tij për t’u zgjeruar. Siç duket, njeriu i Neandertalit i ka kushtuar një pjesë të mirë të mendjes përfytyrimit dhe zotërimit të trupit, ndërkohë që njeriu i sotëm e përqendron fuqinë mendore në ruajtjen e marrëdhënieve të ndërlikuara dhe të tejzgjatura shoqërore (të nevojshme për të konkurruar për përvetësimin e burimeve të pakta), gjë që kërkon një gjuhë më të stërholluar. Vargjet e Kuranit që këshillojnë shumëllojshmëri, janë të mirënjohura dhe asnjëherë nuk mjafton të përsëriten: “Ne... ju kemi krijuar në kombe dhe fise, që ju ta njihni njëri – tjetrin” (49:13). “Sikur të donte Zoti, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë...” (5:48). Kurani, gjithashtu, na tregon se shumëllojshmëria e gjuhëve dhe ngjyrave njerëzore është shenjë e njerëzve të dijes (30:22). Muhamed Asad vëren vargje të tjera që e mbështesin këtë gjë dhe, sipas mendimit të tij: “Ndryshimi i vazhdueshëm i mendimeve dhe ideve të njeriu nuk është rastësor, por përfaqëson një rrethanë themelore të qenieve njerëzore, fryt i caktimit të Zotit”. Profeti Muhamed (a.s.) dëshmohej të ketë thënë: “Shumëllojshmëria e njerëzve të mi është një bekim (*ikhtilaf ummati rahmah*)”.

20 Fjalët e rabinut Abraham Heschel janë përmendur nga: Prince Hasan Bin Talal in Rabbi Jonathan Magonet, *Talking to the Other: Jewish Interfaith Dialogue with Christians and Muslims* (London: I.B. Tauris, 2003), fq. vii.

21 Thëniet nga Nancy Kline janë marrë nga punimi i saj me titull: *Time to Think: Listening to Ignite the Human Mind* (London: Lock, 1999), p. 97. Sa u përket teorive të kohëve të fundit, lidhur me shfarosjen e Neandertalit, shikoni: *Why did the Neanderthals die out?* (*The Guardian*, 2/6/13), publikuar më 1/12/14, në: <http://www.theguardian.com/science/2013/jun/02/why-didneanderthals-die-out>

Është e rëndësishme të dallojmë shumëllojshmërinë e ideve, si një mësim në vazhdimësi, me mediokritetin e pakundërshtuar, për hir të të qenit dorëlëshuar. Omid Safi na rikujton se domethëniet e fjalës “tolerancë” janë thellësisht të dyshimta, të rrënjosura si vetë fjala, në helmën dhe drogën mesjetare, që shënonte se sa shumë helm mund të toleronte trupi i njeriut, përpara se t’i dorëzohej vdekjes. Siç e arsyeton edhe Diana Eck, në mënyrë shumë shprehëse, pluralizmi nuk është thjesht qenia “shumicë” apo “qytetar i botës”, si një varg fushimesh të veçuara apo krahinash të izoluar. Pa një përpjekje të mirëfilltë, thotë ajo, do të ishin vetëm “ikona të shumëllojshmërisë” dhe jo “mënyra marrëdhëniesh”. Pluralizmi nuk është as shpëlarje dhe as përzjerje e lirë përfytyrimesh e zotimesh, aq më tepër një copë ngushëllimi i ulët, në lidhje me pikat e përbashkëta të shërbyera në takimet mbi çështjet ndërfaqetare.²²

Ai është një përpjekje në kërkim të së vërtetës, një ndryshim i dyanshëm në vazhdimësi, i cili shkon më tej sesa thjesht një përpjekje për të kuptuar “tjetrin” dhe që mbërrin në një nivel të ri të vetë kuptimit të ndërsjellë.

Kujdesi për marrëdhënien është thelbi i takimit me të panjohurën. Një nga mënyrat më të rëndësishme për të zhvilluar mundësitë e ndërtimit të një marrëdhënieje, qëndron në një arsimim të gjerë, të baraspeshuar dhe të plotë, i cili jep hapësira të mjaftueshme për artet dhe njerëzimin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, nëse marrim parasysh përpjekjet e vazhdueshme për mënjanimin e këtij lloj arsimit në programet e shkollave kryesore. Në të gjitha nivelet e metodave mësimore, brenda

22 Punime të tjera në lidhje me shumëllojshmërinë, të cilave u jam drejtuar, përfshijnë: Diana L. Eck, *Encountering God* (Boston: Beacon Press, 1993), fq. 198; Omid Safi (ed.), *Progressive Muslims on Justice, Gender and Pluralism* (Oxford: Oneworld Publications, 2003, fq. 24; dhe Khalid Abou El Fadl, *The Place of Tolerance in Islam* (Boston: Beacon Press, 2002), fq. 16

shoqërisë muslimane, ky mënjanim mund të jetë më i vogël.²³ Një arsimim i pasur në shkencat humane do të ushqente zhvillimin jo vetëm të aftësive të mendimit krijues dhe kritik, të pyeturit dhe hulumtimeve pa paragjykime, por edhe aftësive të dobishme ndërlihdhëse, përmes bisedave dhe debateve. Gjithashtu do të nxishte një varg mundësish të tjera: përfshirjen në artet krijuese, si mënyrë e zotërimit të shpirtit, ndezjen e përfytyrimit, zhvillimin e diturisë estetike dhe nxitjen e ndërlihdhjes trunore, hulumtimit disa shqisor si dhe mësimin të drejtpërdrejtë nga përvoja, sidomos të bukurive dhe madhështive mjedisore të natyrës, kuptimin e gjendjes njerëzore, përmes mësimin të historisë, gjeografisë, gjuhës, letërsisë dhe shkencave të natyrës, lëvrimin e zemërgjerësisë dhe idesë së mëshirimit, të cilat vlerësojnë dhe nderojnë shumëllojshmërinë dhe, në mënyrë veprare, kujdesen për ndërgjegjësimin ndërkulturor, zhvillimin e karakterit, mirësinë dhe kujdesin ndaj të tjerëve, e zbatuar në sjellje vetjake, marrëdhënie, qytetari, tregti, jetën e përditshme, bamirësi, apo në kujdesin ndaj mjedisit që është një shqetësim kaq i ngutshëm për ne të gjithë.

Arsimi duhet të theksojë fuqinë ndërvepruese dhe të njohjes së “tjetrit”, duke na bërë kështu, të pasurojmë dhe përmirësojmë veten tonë.

23 Padobishmëria në rritje e shkencave njerëzore në rrjedhat qendrore të arsimit në UK, është dokumentuar fuqimisht në: *The Cambridge Primary Review*, nga Robin Alexander (<http://www.primaryreview.org.uk/>). Në lidhje me pluralizmin, gjithashtu kam nxjerrë disa të dhëna nga punimet e mia të mëparshme, që përfshijnë: Jeremy Henzell-Thomas, *The Challenge of Pluralism and the Middle Way of Islam*, në Roger Boase (ed.), (2005, op. cit.), fq. 267-272; *Beyond the Tower of Babel: A Linguistic Approach to Clarifying Key Concepts in Islamic Pluralism*, në Wanda Krause (ed.), *Citizenship, Security and Democracy: Muslim Engagement with the West* (Richmond: AMSS UK, 2009), fq. 32-4; *British and Muslim: Holding Values to Account through Reciprocal Engagement*, *Arches Quarterly*, 4:8 (2011), fq. 30-43.

RREGULLIMI I SHKOLLIMIT

Një pjesë të vëmendjes sime, ia kam kushtuar rëndësisë së mendimit të përgjithshëm mbi pluralizmin, shumëllojshmërinë, shkëmbimet kulturore, marrëdhënien dhe zgjerimin e horizonteve të dijes, ngaqë ka një lidhje të dukshme midis të gjitha këtyre, në njërën anë, dhe bisedave, ligjëratave shtjellimeve, bashkëbisedimit, kërkimit të së vërtetës nga më shumë se një këndvështrim, si treguesi i çdo arsimit të fuqishëm dhe vazhdimisht në përmirësim. Kjo është pikërisht ajo gjë që na jep fuqinë e të ndryshuarit të vetes sonë, shoqërisë dhe mbarë botës. Brenda degës së psikologjisë zhvillimore të Perëndimit, Karl Riegel veçon aftësinë e pranimin të kundërshtimit, ballafaqimeve dobiprurëse, paradokseve, mospërputhjeve kohore, si shkalla më e lartë e zhvillimit të njohurive. James Fowler, nga ana tjetër, e lidh mendimin përzgjedhës me zhvillimin e besimit. Është e vetëkuptueshme se veprimi përzgjedhës, nuk është as ujdë dhe as relativizëm i shturur, por një tendosje krijuese, e cila përfundimisht i shndërron kundërshtitë në plotësim, duke çliruar mendimtarin pa paragjykime nga zakonet e rrënjësura dhe skemat e kushtëzuara mendore, lidhjet e përcaktuara, frika nga ndryshimi dhe paqëndrueshmëria, ngurrimin ndaj çdo lloj qasjeje që mund të kërcënojë kuptimin për “vetveten”.

Atëherë, a kanë shkollat tona një kulturë bashkëbisedimi? Roland Barth na njehtë me vlerësimin e John Goodlad dhe të tjerëve, në lidhje me faktin se pedagogjia sunduese në Amerikë, e bazuar në parimin: mësuesit flasin dhe nxënësit dëgjojnë, ia kushton 85% të orës së mësimit shpjegimit dhe rrallëherë e ndërthur me bashkëbisedimin e drejtpërdrejtë me mësuesin.²⁴ Mund të kishim shpresuar se me të njëjtën epërsi kohore të mësuesve për t’u shprehur në shkollat tona në Britaninë e Madhe, një pjesë e mirë

24 Kritikën e Roland Barths mbi fjalimin (retorikën) e tepruar të mësuesve, në librin e tij *Learning by Heart* (San Francisco: Jossey-Bass, 2001).

e saj mund të drejtohej për nga zhvillimi i mendimit krijues dhe përcaktues. Mirëpo, nuk ndodh kështu. Në të vërtetë, një studim i gjerë në shkollat e mesme britanike, ka treguar se më pak se 10% e ligjërimit të mësuesve shkon në të mirën e zhvillimit të aftësive të mendimit të një rendi më të lartë. Pjesa më e madhe e saj shkon përkundrajt zotërimit dhe organizimit, duke përfshirë rregulla e udhëzime, si dhe një nivel të ulët përcimi faktesh dhe të dhënash. Shumica e pyetësorit të nxënësve thjesht është përshtatur, me qëllim përpjekjen për të sjellë ndërmend “përgjigjet e duhura” në marrëdhënie me përmbajtjen e përshkruar, siç e kërkon regjimi i provimeve dhe vlerësimeve të bezdisshme, në vend që të nxitet bashkëbisedimi, përmes së cilit këndvështrime të ndryshme apo kërkshëria për njohuri të një niveli më të lartë.

Një metodë arsimit që përqendrohet së tepërmi në parimin e mbartjes së të dhënave të nxënësit, kryesisht përmes mësuesit (ajo që mësuesi i Harvardit, Roland Barth, e quan: “Ulu dhe dëgjo, i pagdhendur!”), nuk mund të përfshijë zgjimin dhe mençurimin e vargut të pafund të aftësive njerëzore. Sipas kuptimit islam të arsimimit, theksimi i tepërt në këshillimin dhe stërvitjen e mendjes si dhe në përcimin e të dhënave të nxënësit, kryesisht përmes mësuesit (*talim*), në kurriz të një edukimi më të gjerë (*tarbiyah*), cenon paprekshmërinë e përvojës arsimore. Një mësues i mirë nuk është vetëm *mualim*, përçues i dijeve, por edhe një *murabbi*, ushqyes shpirtëror dhe zhvillues tipari. Ka një nevojë të ngutshme për rigjallërim të vërtetë të parimeve cilësore të përgjithshme, përballë qasjeve të molisura, më shumë praktike sesa tërheqëse, që burojnë nga nxitja drejt përmbushjes së objektivave të vendosura nga drejtuesit, të cilat i kthejnë njerëzit në blerës të përkushtuar, në shërbim të materializmit shkatërrimtar, rritjes ekonomike të paqëndrueshme dhe të shkatërrimeve mjedisore. Kjo qeverisje bashkëkohore ka qenë në qendër të vëmendjes së shumë kritikëve, duke përfshirë John Taylor Gatto dhe padinë e famshme të tij mbi kapardisjet dhe ngrehinat mbi të cilat është

ndërtuar mësimi bashkëkohor shtetëror në Amerikë.²⁵ Gatto nxjerr në pah të njëjtën vazhdimësi kalbëzuese që shpalos politikat arsimore britanike, që kanë përshtatur si rend dite kthimin e fëmijëve në hallka të makinerisë ekonomike, fëmijë të cilët janë të varur, në përputhje me vlerat materiale dhe mungesën e kërshërisë, krijimtarisë, përfytyrimit, vetënjuhjes, mungesës së fuqive mendore kërkimore dhe pasqyruese, si dhe aftësive për ta përballuar vetminë. Neil Postman, kritik i rëndësishëm social amerikan, gjithashtu ka theksuar me keqardhje mënyrat se si shkolla sot nxit “të mirat false” të mirëqenies ekonomike dhe përdorimit të tyre.²⁶

Një nga fuqitë më jetësore të arsimit, duhet të jetë aftësia për të na përgatitur të kundërshtojmë çdo lloj indoktrinimi. Më lejoni të tregoj një shembull domethënës. Një shkresë nga Këshilli Profesional i Arsimit Fetar, ka zbuluar se në mes të nxënësve të shkollës së mesme, nga mosha 11-18 vjeç, ata që përfitojnë nga Arsimi Fetar dhe shohin të mirat e tij për jetën e tyre duke studiuar atë, tejkalojnë katër me një (4/1) të tjerët që janë kundër këtij lloj arsimimi. Raporti gjithashtu jep shembuj të paraqitur nga nxënësit, që tregojnë se shumë prej tyre u pëlqen lënda fetare, për shkak të mundësisë që u jep për të shprehur mendime, të përmirësojnë aftësitë bashkëbiseduese, të përvetësojnë njohuri mbi besimet e tjera, të zhvillojnë dijet e ndjesitë ndërkulturore, të zhvillojnë aftësitë filozofike të hetimit dhe pasqyrimit si dhe të peshojnë kuptimin dhe qëllimin e jetës.²⁷ Mbase mund të ketë fare pak mundësi të tjera brenda programit shkollor për një pasurim të tillë. Ky fakt bie ndesh me paragjykimet e zhurmshme ideologjike të atyre që, në mënyrë të prerë, kundërshtojnë arsimin fetar si “mësime mbi

25 Po ashtu, John Taylor Gatto, *Dumbing Us Down: The Hidden Curriculum of Compulsory Schooling* (New Society Publishers, 1992).

26 Për trajtimin e Neil Postman mbi idhujt e rremë që dobësojnë arsimin, shih librin e tij *The End of Education: Redefining the Value of School* (New York: Vintage Books, 1996).

27 Raporti mbi përhapjen e arsimit fetar në mesin e studentëve të UK, është bërë nga: L. Blaylock (ed.), *Listening to Young People in Secondary Religious Education*, Professional Council for Religious Education (PCfRE), shtator 2001.

fenë”, siç është rasti i “filozofit” A. C. Grayling, njëherë e përshkroi arsimin fetar si “keqpërdorim mendor” dhe shkollat fetare si “geto të besëtytnisë”.²⁸ Ndërkohë që mësimi mbi fenë dhe mungesa e mendimit dhe bashkëbisedimit cilësor mund të veçojë pikëpamje të ndryshme në vazhdimësi të arsimit te disa shkolla fetare, është së tepërmi çorientuese të barazosh mangësi të tilla me arsimin fetar në përgjithësi. Përgjithësime të tilla jo vetëm që shfaqin nënvlerësim për faktin që gjendesh befasisht në vetë-emërimin kampion të mendimit kritik, por një mungesë e gjunjëzuar prerazi e vlerësimit të vetë të rinjve. Ndërkohë që lidhja e indoktrinimit me fenë mund të jetë mekanike dhe jo frymëzuese, brenda disa mendimeve të kushtëzuara nga kultura.

Ne duhet të kuptojmë se arsimi fetar, në njëfarë shkalle, është i ngulitur në rrjedhat kryesore të sistemit arsimor që e kemi emëruar gjerësisht si “laik”. Doris Lessing në *Librin e Artë*, shkruan:

Ne ende s’kemi zhvilluar një sistem arsimor që të mos jetë sistem i indoktrinuar. Ata që janë më të fuqishëm dhe më të veçantë se të tjerët, janë të lutur të gjejnë mënyra të tjera për të arsimuar vetveten, të arsimojnë aftësitë e veta gjykuese. Ata që do të rrinë, duhet ta mbajnë mend gjithmonë dhe në çdo kohë, se do të brumosen dhe zbukurohen për të qenë të pranueshëm për nevoja të veçanta të një shoqërie të veçantë”.²⁹

Filozofja e shkencave shoqërore, Hannah Arendt, e përkufizon kështu: “Edukimi i plotë nuk ka pasur kurrë si qëllim të rrënjosë bindje, por të shkatërrojë aftësitë për të formuar ndonjë bindje”.³⁰

Arsimi duhet të ketë guximin të bëjë pyetje kërkuese, të çrrënjosë paragjykimet tona dhe t’i bëjë ballë indoktrinimit.

28 Mendimet e Grayling mbi arsimin fetar janë dhënë në BBC Radio 4’s Moral Maze, më 1 qershor 2002. Shih dhe artikullin e tij në “The Guardian”, *Ghettoes of Superstition* (11/9/07) <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2007/sep/11/ghettoesofsuperstition>.

29 Thënia e Doris Lessing është marrë nga libri i saj rreth mësimdhënies, me titull: *The Golden Notebook* (Harper Perennial, 2007).

30 Thëniet e Hannah Arendt, lidhur me arsimin e detyruar, janë marrë nga libri i saj me titull: *Totalitarianism* (New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1968), fq. 168.

MËSIMET E GABUARA - MENDËSITË E KUSHTËZUARA - DYZIMET-KEQPERCEPTIMET

Ne mund të përfshijmë në grupimin e “zakoneve të ngulitura dhe mendjeve të kushtëzuara“ edhe joshjen e “mësimeve të gabuara“, ato mësime me të meta dhe të imponuara të së shkuarës, të cilat rrjedhin nga përpjekjet e vazhdueshme për t’i dhënë botës kuptim.³¹ Është provuar qartë, që deri edhe bashkësia shkencore më e “arsyeshme“, shpreh dyshime lidhur me pohimet e njëanshme. Në të njëjtën mënyrë, siç e dimë nga psikologjia e perceptimit, mendja njerëzore ka prirje të shohë atë që do të shohë, apo atë çka pret të shohë. Parapëlqimet e përshtypjes, sigurisht që janë të kuptueshme dhe madje të nevojshme. Pa shprehitë e shpejta vetëvepruese, të cilat janë pasojë e vendimmarrjeve nga lart, nuk do ishim në gjendje të vepronim në botën që na rrethon, ngaqë do të na duhej të shqyrtonim vazhdimisht gjithçka nga poshtë-lart, sikur të ishim duke u ballafaquar me të për herë të parë. Të mirat që i mbijetojnë përpunimit ditor të të dhënave, janë dukshëm shprehje e qartë e një ndarjeje boshtore të baraslarguar, e cila në vetvete është e rrënjosur deri diku brenda nesh, që do të thotë: Gjyko dhe vepro me vendosmëri! Nga ana tjetër, filozofi i kolltukut vëzhgon me kujdes çdo hollësi të arsyetimit të çdo lloj pohimi, përvetëson çdo cilësi, vlerëson çdo vendndodhje dhe stërmundohet rreth çdo lloj mosmarrëveshjeje të vogël dhe ngjyrimi që mund të japë dhe mund të mos shkojë kurrë më larg se kolltuku i tij. Sigurisht që duhet të bëjmë dallimin midis zhvillimeve të mira të “tregimeve“ të njohura nga ne, që na ndihmojnë në lidhjen logjike dhe rregullin në botën që na rrethon, si dhe pasojave të këqija të ngulitura në prirjet njerëzore, në lidhje me qëndrimet e një anshme fisnore, fanatizmin dhe paragjykimin. Përbalja me përsëritjen mekanike të mendimit njëpërmasor dhe “teksteve“ të palidhura, duhet të jetë një nga detyrat

31 Në lidhje me dukurinë e “të mësuarit gabim“, shikoni: Nassim Nicholas Taleb, *The Black Swan: The Impact of the Highly Improbable* (New York: Random House, 2007) dhe Daniel Kahneman, *Thinking, Fast and Slow* (London: Penguin Books, 2012).

më të rëndësishme, jo vetëm e mendimtarëve dhe hulumtuesve në botën akademike më të përparuar, por edhe e gazetarëve të përgjegjshëm, vrojtuesve dhe vlerësuesve kulturorë që i janë kushtuar kërkimit të vërtetësisë në nxjerrjen, ndërthurjen dhe vlerësimin kritik të dëshmimeve. Ky funksion është gjithmonë më i rëndësishëm sesa thjesht ai i kundërshtisë, ku përmbysja bëhet qëllim në vetvete, apo për të mbrojtur një qëndrim me çdo çmim. Për më tepër, bazohet në ndërmarrjen e ndershme të kritikës intelektuale, përmes mendimeve të ndryshme, kundërshtive të arsyeshme dhe të dhënave kundërshtuese në shërbim të pasurimit gjithnjë e më të madh të dijes njerëzore. Një nga parimet themelore të qytetërimit perëndimor, mbështetet në pohimin e Platonit, se procesi i dialektikës filozofike është tërësisht i ndryshëm dhe pakrahasimisht epror ndaj retorikës, si mënyrë e mbushamendjes, gjë që është e vërtetë edhe sot, po aq sa ç'ishte në kohën e Akademisë së tij.³²

Një nga dhjetë kërkimet më popullore në internet rreth Fuqisë së Arsimit, përmend shumë të përsëriturën thënie që i përket filozofit anglez të shek. XVII, Francis Bacon: “Dija është fuqi”. Thënia latine me të cilën është shprehur filozofi (*ipsa scientia potestas est* - “Dija në vetvete është fuqi”), gjendet në librin e tij: *Meditationes Sacrae*, shkruar më 1597, në të cilën ai qartëson ekuacionin e dijes dhe fuqisë, duke shtuar se dija nuk është “thjesht shkëmbim i mendimeve të kundërta, apo një zbukurim”.³³ Me fjalë të tjera, si pasojë e mërzitjes së tij me traditën e ngulitur të skolastikës, Bacon donte të rilidhte dijen me veprimin, për të prodhuar njohuri praktike të

32 Për mësimet e Platonit mbi përparësinë e dialektikës mbi retorikën, shikoni: R. Wardy, *Rhetoric*, në J. Brunschwig, dhe G. Lloyd (eds.), *Greek Thought: A Guide to Classical Knowledge* (Cambridge, Mass.: The Belknap Press of Harvard University Press, 2000), fq. 465. Për dialektikën si mënyrë e përparuar e mendimit njerëzor, lexoni: Karl Riegel, *Dialectic Operations: The Final Period of Cognitive Development, Human Development*, 16:5 (1973), dhe James W. Fowler, *Stages of Faith: The Psychology of Human Development and the Quest for Meaning* (San Francisco, CA: Harper and Row, 1981).

33 Libri i Francis Baconit: *Meditationes Sacrae* (1597), mund të lexohet në një riprohim të botuar nga Kessinger Publishing Co., 1996 dhe 2010. Po ashtu, Bacon, *The Four Idols* (fillimisht në *Novum Organum*) në James D. Lester (ed.), *Plato's Heirs: Classic Essays* (Lincolnwood: NTC Publishing Group, 1996), fq. 53-63.

mbështetura në parimin e provës dhe vëzhgimit “në dobi dhe në përdorim të njerëzve”.

Për këtë qëllim, Bacon theksonte se ne duhet të pastrojmë mendjen nga paragjykimet, kushtëzimet, mendimet e kota dhe bindjet e pamarra në shqyrtim, të cilat ai i quajti “idhujt e mendjes njerëzore”, të cilat shtrembërojnë dhe zbehin natyrën e vërtetë të gjërave dhe, në vend të tyre, mbështetjen në përvojat e drejt-përdrejta, përshtypjen, vrojtimin dhe përthithjen e vërtetë, si mënyra përfitimi të njohurive të shëndosha. Përgjatë shembujve më të përcaktuar të pengesave drejt të kuptuarit, të përfshira në “*idhujt*” e Bacon, janë: përpjekja për t’i bërë gjërat të përshtatshme për një model të vetëm, kërkimi i dëshmimeve që mbështesin mendimet e paracaktuara, këqyrja e asaj çfarë dikush pret ta shohë, besimi në atë që dikush do të besojë, përgjithësimi, përkrahja e një pikëpamjeje mbi tjetrën (p.sh.: lashtësinë mbi risinë, të pjesshmen mbi tërësinë, ndryshimet ndërmjet ngjashmërive apo anasjellas), si dhe dështimi për të kuptuar që fjalët kanë më shumë sesa një kuptim. Kjo është një renditje kaq e shquar, sa që tingëllon tejet bashkëkohore dhe përputhet kaq fort me disa nga përfundimet bashkëkohore të psikologjisë së njohjes dhe të fushave të tjera, lidhur me llojin e kushtëzimit, paragjykimin, miratimin e njëanshëm si dhe pengesa të tjera që lidhen me mësimin.

Sa i përket mendësisë së ndarjes së gjërave me thikë, ajo është e ngulitur në përmbajtjen arsimore, ashtu sikurse në shumicën e fushave të tjera të mendimit dhe veprimtimit njerëzor. Shembuj të qartë janë: ideja e gabuar se të mësosh gjëra përmendësh është disi armiqësore me të menduarit dhe të kuptuarit, ose fakti që krijimtaria është disi e pavarur kundrejt dijeve jetësore.³⁴

34 Në lidhje me vlerat e kujtesës, lexoni: Michael Knox Beran, *In Defense of Memorization*, City Journal, summer, 2014. Për marrëdhëniet midis krijimtarisë dhe tringut mendor, shikoni: Robert Weisberg, *Creativity and Knowledge: A Challenge to Theories*, në Robert J. Sternberg (ed.), *Handbook of Creativity* (Cambridge: Cambridge University Press, 1999). 5%

Është një tjetër pikëpamje e gabuar, që e veçanta - grumbullim i një trupi të caktuar imtësisht mbi njohuritë - është disi në kundërshtim me shkallën e lartë dhe ndërlidhjet e përfituara nga mësimi në shumë lëmi të jetës. Dijetarët e mëdhenj (përfshi ata që kanë qenë frymëzim i madh për mua) nuk janë më amatorë që lundrojnë në sipërfaqe të puseve të cekët, sesa specialistët që domosdoshmërisht vuajnë nga përqendrimi i ngushtë që i ndalon ata të shohin gjërat në tërë gjerësinë e mundshme.

Le të kthehemi tani edhe te një pikëpamje tjetër e gabuar, e nënvizuar nga Bacon: "Shtrembërimi i përshtypjes mbi vërtetësinë jetësore, si pjellë e ideve të ngurtësuara dhe pritshmërive, si dhe mospërfillja ndaj të dhënave që e shoqëron atë". Një hulumtim i botuar kohët e fundit në *The Times*, i nëntitulluar me të drejtë "Treguesi i padijes", nxori në pah mbivlerësime të habitshme në renditje të ndryshme, përfshirë këtu edhe numrin e mërgimtarëve dhe muslimanëve në 14 vende.³⁵ Të anketuarit amerikanë, fjala vjen, besonin që muslimanët përbënin 15% të popullsisë në SHBA, ndërkohë që të dhënat tregojnë se kjo shifër është vetëm 1%. Njerëzit, në mënyrë të vazhdueshme, ushqehen me lajme të ndjeshmërisë së lartë, përmes shtypit, rreth gjërave që përbëjnë shqetësim për ta, këtu përfshihen edhe prirjet për të mbivlerësuar. Një shembull tjetër i përshtypjes së gabuar mbi realitetin, është edhe mbivlerësimi i dhunës së nxitur nga feja. Ia vlen të përmendim, se në kundërshtim me krijimin e përshtypjes së gabuar, se feja historikisht ka qenë arsyeja kryesore e përplasjeve të dhunshme, në bazë të përllorëgaritjeve, në rastin më të keq, ajo ka shkaktuar vetëm 3% të 248 milion vdekjeve të shkaktuara nga dhjetë luftërat, masakrat dhe egërsitë më të ashpra të historisë njerëzore.

Arsimi duhet të ketë fuqinë e grumbullimit të një sërë dijes, të rendisë dëshmi dhe t'i bëjë ballë mendimeve të njëanshme, të kushtëzuara dhe njëpërmasore.

35 Sondazhi i Ipsos Mori mbi perceptimin publik, bazohet në 11.527 intervista, në 14 vende dhe është botuar në *The Times*, më 30/10/14.

PËRMBUSHJA E AFTËSIVE NJERËZORE

Unë e marr si të mirëqenë faktin se arsimit vërtet cilësor mund të mbështetet vetëm në të kuptuarit me pjekuri të të gjithë shtrirjes së aftësisë dhe fuqisë njerëzore: trupore, ndjesore, njohëse, përfytyruese, morale, shpirtërore si dhe mprehtësisë, duke mos harruar se nga këndvështrimi shpirtëror, të gjitha këto fuqi dhe aftësi të tilla, janë dhurata hyjnore dhe se: “nuk ka fuqi, as forcë, përveç Zotit të vetëm” (*la haule ue la kuvete ila bil-lah*). Mendimi dhe ushtrimi i arsimit tërësor është gjithashtu pjesë përbërëse e përfytyrimit të plotë mbi aftësitë njerëzore në Islam. Kurani na porosit herë pas here, që t’i përdorim aftësitë e dhëna për të përfituar njohuri, me qëllim për ta parë qartë të vërtetën. Ato përfshijnë shqisat që na mundësojnë mësimin nga vëzhgimi i drejt-përdrejtë dhe përvoja, ashtu dhe përmes udhëzimeve: aftësive gjuhësore diskutuese apo arsjetuese (*‘aql*), të cilat na mundësojnë të mendojmë, shqyrtojmë, përfundojmë, dallojmë, konceptojmë, kundërshtojmë dhe të përfshihemi në vazhdimësinë e kërkimit të së vërtetës, aftësive për ndërtimin e marrëdhënieve dhe ndjeshmërisë, e cila është fusha ndërvepruese me “tjetrin”, që na porosit Kurani. Sa më të larta aftësitë e “arsyetimit” që ndërthurin mendjen dhe zemrën, duke përfshirë pasqyrimin dhe soditjen (*tafakkur*), përfytyrimin krijues i cili tërheq aftësitë e përshtypjes dhe mprehtësisë së brendshme, aftësitë morale të gdhendura në parime (*furqan*), që na mundësojnë të dallojmë ç’është mirë dhe ç’është keq, aq më shumë mundemi të marrim përgjegjësi vetjake dhe përgjegjësi përfundimtare, në lidhje me veprimet tona. Përveç të gjitha këtyre, aftësinë mbizotëruese të vetëdijes apo ndërgjegjësimit të pranisë së Zotit (*takva*), të ndjenjës së dashurisë së frikshme, si dhe ndërgjegjësimit mbi praninë e Zotit dhe dëshirës për të drejtuar jetën e dikujt, drejt dritës së këtij ndërgjegjësimit. Kjo është pamja e përgjithshme e aftësive njerëzore që nuk e ndan kurrë fuqinë e arsyes me atë të

përvojës së drejtpërdrejtë, vlerësimet morale apo vetëdijen shpirtërore.

Fjala angleze për zhvillimin “develope” vjen nga frëngjishtja e vjetër: *des+veloper*, “çmbështjell”, një pikëpamje në përputhje me kuptimin “udhëhiqe ose bëje të flasë”, në latinisht thuhet *educere*, nga ku buron fjala angleze “education” (arsim). Pikëpamja e çmbështjelljes ka në thelb arsimimin e vazhdueshëm i cili përfshin: mbajtjen mend, vënien në veprim, zgjimin, shquarjen apo nxjerrjen në dritë të aftësive të lindura, që pasqyrojnë natyrën thelbësore me të cilën qenia njerëzore është e krijuar nga Zoti dhe që e pajis njeriun me aftësinë e të qenit mëkëmbës (*khalif*) i Zotit në tokë. Zanafilla e fjalës angleze ‘character’, vjen nga greqishtja *kharakter*, vegël e cila shërben për të shënjuar, nga *kharassein* - me gdhendë. Një nga kuptimet e saj vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite një shenjë e shkrimit. Gërmimi i kuptimit fillestar na çon në pikëpamjen se karakteri njerëzor me të cilin lindim, është gdhendur, vulosur, ngulitur apo skalitur në shpirtin tonë, duke qenë i krijuar nga Zoti, siç na tregon edhe Kurani (95:4) “*fi ahseni taqvim*” (në trajtën më të mirë), sipas Arberry ose (në përshtatjen më të mirë) sipas Muhammad Asad. Si rrjedhojë, zhvillimi i karakterit është çmbështjellja e vulës hyjnore, ndërgjegjësimi ndaj fuqisë, shprehja e njeriut aq sa është i zoti t’i shprehë tiparet hyjnore. Duke vazhduar për një çast me këtë pikëpamje të “fuqisë” dhe “mundësisë” njerëzore, të dhëna nga Zoti, nëse kërkojmë në Google: “Fuqitë njerëzore”, nga 258 milionë kërkime, pesë më të mirat përfshijnë faqet në vazhdim: *16 People with Real Super Powers; 18 Mutant Superheroes; 9 Humans with Real-Life X-Men Mutant Super Powers* dhe *3 Ways to develope Powers*. Kjo e fundit, e hartuar për “ata të cilët të qenit thjesht njeri nuk u mjafton”, përfshin në vetvete: shikimin në errësirë, hedhjen nga muret, kërcimin si mace, shmangien e nevojës së frymëmarrjes, aftësinë e zbulimit të gënjeshtreve, bindjen e të tjerëve përmes nënvetëdijes, leximin e ndjenjave dhe zhvillimin e mendjehollësisë, nuhatjes së

heshtjes, parashikimin yjor dhe lëvizjen e sendeve me fuqi trunore. Ndikimi i shtypit dhe kulturës mbizotëruese këtu është mëse i qartë. Mirëpo, mahnitja me yjet dhe fuqitë hyjnore është një tregues i thellë i ndërgjegjësimit rreth mundësive të njeriut. Në të njëjtën kohë, dikush mund të mendojë se lulëzimi i mendimeve të tilla, ka lidhje me kohët të cilat po kalojmë, ku fuqia e plotë e qenieve njerëzore si dhe hapësira e plotë e aftësive njerëzore në masë të gjerë janë të panjohura, në një kulturë ku pritshmëritë e ulëta përhapen çdo ditë, diçka që e gjejmë qoftë në arsim, qoftë në mbarë shoqërinë. Të pavetëdijshëm për hapësirat e plota të mundësive tona, ne vetëm mund ta përpunojmë këtë pavetëdije në përfytyrim, qenie dhe fuqi të bujshme.

Arsimi duhet të ketë fuqi, që të miratojë hapësirat e plota të fuqisë dhe aftësisë njerëzore, por dhe të na mundësojë zotërimin e vetëdijshëm të ndryshimeve brenda vetes sonë.

PËRSOSMËRI PËRMES SHPIRTIT

Në filmin *Under Siege*, ku rolin kryesor e luan Steven Seagal, Tommy Lee Jones luan rolin e një mashtruesi, ish-agjent i CIA-s, i cili kishte qenë i ngatërruar në ndërhyrje të fshehta me forcat e posaçme që marrin peng një anije luftarake amerikane. Ai është një i marrë krejt i pamoralshëm, mirëpo, kur CIA pyetet se përse e kishte punësuar, përgjigjet me fjalët e një “mendimtari krijues”, se “ai ishte njeriu që veçanërisht na duhej”. Këtu shohim një shkëputje midis “krijimtarisë” dhe çdo përfytyrimi tjetër më të lartë mbi karakterin njerëzor. Krijimtaria në këtë rast, në vend të jetë shfaqje e përsosmërisë njerëzore, është shprehur thjesht si zgjuarsia, pa një paramendim të lidhur me qëllimet për të cilat është përdorur.

Në vitin 2010 e gjeta veten në një rrethanë të pazakontë, kur po mbaja një fjalim kryesor, gjatë kremtimit vjetor të Bajramit, në

mjediset e Goldman Sachs, në qytetin e Londrës. Tubimi mbahej nën parullën e tyre të programit mbi "larmishmërinë". Fjalimi im titullohej "Islami dhe përsosmëria njerëzore", mbi bazat e të cilit përcaktoheshin edhe themelet e parimeve të tij, që përfshinin (përveç larmishmërisë) kualifikimin, krijimtarinë dhe ndershmërinë. E fillova fjalimin, duke thënë se të gjithë të pranishmit, pa dyshim, e dinë që filmi *Wall Street 2: Money Never Sleeps*, vazhdim i filmit *Wall Street*, prodhim i vitit 1987, së shpejti do shfaqej në kinematë tona. Kush mund ta harronte Gordon Gekkon në filmin e parë, luajtur nga Michael Douglas, apo thëniet e tij me nam, si: "Lakmia është e mirë; unë nuk krijoj asgjë, unë zotëroj; ne i shkruajmë rregullat, o mik; ka të bëjë vetëm me paratë bir, pjesa tjetër është bisedë; çfarë vlen të bëhet, vlen të bëhet vetëm për para". Përmenda bisedën e para një muaji me Michael Douglas, në të cilën ai më tregoi se si, njëherë, gjatë vitit 1987, kur sapo kishte dalë filmi, studentët e ekonomisë u mbledhën për ta takuar dhe i thanë: "Gordon Gekko! Ti je burrë i vërtetë Gordon, Ti je shkaktari që unë i kam hyrë lojës me lekët". Douglas, duke tundur kokën, kishte thënë: "Jo jo, vërtet jo! Shikoni filmin! Nuk jam njeriu që ju do të donit t'i ngjanit. Unë jam horr". Ata nuk e kishin kuptuar. "Gordon, ti je vërtet madhështor". Douglas ma ktheu: "Tani vras mendjen, se sa nga këta studentë që po mbaronin degën e administrim-biznesit në atë kohë dhe mendonin se Gordoni ishte kaq madhështor, mund të jenë duke drejtuar tani të njëjtat ndërmarrje". Ka një veçori dalluese shumë të rëndësishme midis të qenit i kualifikuar dhe të qenit i përsosur. Në fund të fundit, ne mund të flasim për një shenjtor të kualifikuar, por, a nuk do ishte e çuditshme ta quanim Marion njeri të përsosur, veç nëse do ishim anëtarë të mafias?! Ndryshimi qëndron në faktin se thelbi i përsosmërisë nuk ka të bëjë me mjeshtërinë vetjake të një aftësie, apo dobinë e përmbylljes së një pune. Përsosmëria ka të bëjë me karakterin që ka në vetvete një përmasë morale dhe, si rrjedhojë, edhe shpirtërore. Kjo është një pikëpamje themelore në traditën

islame. Përfytyrimi i “përsosmërisë”, i shprehur në fjalën arabe *ihsan*, në të vërtetë, është e pandashme nga mirësia, bukuria dhe virtyti. Në fushën e artit islam gjendet një veçori dalluese e rëndësishme midis dy këndvështrimeve mbi bukurinë: emërore dhe kalimtare, në njërën anë (*xhema*), si dhe *husn* që shtrihet jo vetëm në ndjesinë estetike mbi bukurinë, në nderimin e “masës dhe raportit përkatës”, harxhuar në krijim, por edhe barazinë e brendshme midis asaj çfarë është e mirë dhe çfarë është e bukur. Në këtë mënyrë, bukuria është e pandarë nga tiparet e Përsosmërisë Hyjnore dhe nga vlerat morale, përsosja shpirtërore dhe përsosmëria e karakterit, të cilat janë pasqyrim njerëzor i këtyre tipareve të shenjta. Në Kuran, aftësitë më të larta gjithmonë janë të ndërthurrura me përfytyrimin e shenjtë, si pjesë plotësuese e qenies njerëzore. Kjo plotësi është kuptimi themelor i “ndershmërisë”, që rrjedh nga latinishtja: *integer* - tërësi, plotësi, e pacenuar.

Nga ky këndvështrim, mendimi, fjala vjen, nuk është vetëm një veprim kuptimplotë, i arsyeshëm dhe shtysë, drejtuar nga qëllimi i cili përparon në kokat tona dhe përmes të cilit madje dhe qëllimi mund të justifikojë mjetin. Mendimi është pjesë e pandashme e aftësive të lindura morale dhe të dallueshme, të mjaftueshme për të bërë dallimin midis së vërtetës dhe gënjeshtres, të drejtës dhe padrejtësisë. Prandaj, përsosmëria e vërtetë është e ngulitur dhe e pranishme në sjelljen parimore dhe bukurinë e vetëpërmbajtjes (*edeb*), sikurse edhe në dobinë dhe aftësinë e zotërimit të një fushe veprimi. Në mjediset e bankës Goldman Sachs, në zemër të Londrës, mund të jem mbështetur në një thënie të shek. XVIII të iluministit londinez, Samuel Johnson – poet, tregimtar, parimor, mendimtar i paanshëm, jetëshkruar, botues, hartues fjalorësh dhe ndoshta njeriu më i rëndësishëm i letrave në historinë e Anglisë. Johnson pati jetuar fare pranë bankës ku po ligjëroja. “Qëllimi më i lartë i arsimit – shkruante ai – është dallimi i gjërave përmes aftësisë, fuqia për të dalluar të mirën nga e keqja, te vërtetën nga gënjeshttra. Ky

përfundim përputhet mrekullisht me përkthimin e fjalës arabe *furkan* nga Muhammad Asad – “matës ose tregues për dallimin e së vërtetës nga gënjeshtra, të drejtës nga padrejtësia”. Ndjesia ndaj vlerësimit moral, paraqitet edhe në fjalë të tjera arabe në Kuran, i cili përmend veçoritë dalluese dhe mprehtësinë. Fjala *el a'raf*, përkthyer nga Asad si “aftësia e dallimit”, mbart të njëjtën domethënie si “marr me mend se çfarë është e drejtë”, siç bën edhe fjala tjetër *rushd* (ndërgjegjësimi për atë që është e drejtë). Fjala *basirah*, që tregon “aftësinë e kuptimit përmes vetëdijes, mbështetur në mendjehollësi”, gjithashtu përfshin atë shtrirje morale që siguron drejtimin thelbësor për të nuhatur të vërtetën. Mendja (*akl*) përfshin jo vetëm aftësitë gjuhësore, arsyen dhe diskutimin (latinisht: *ratio*, greqisht: *dianoia*), por gjithashtu entin më të lartë të mençurisë shpirtërore e morale si dhe mendjemprehtësinë (*intellectus, nous*). Në një hulumtim të imtësishëm mbi hamendësimin rreth *aklit*, Karim Douglas Crow ka vënë re rishfaqjen e fjalës “mençuri” në përshkrimet e fundit të zgjuarsisë njerëzore, për të treguar “ndërthurjen e zgjuarsisë morale dhe shoqërore, atë përzierje të njohurive dhe kuptimit brenda njeriut, të cilat shfaqen në nderin vetjak, vetëdijen dhe sjelljen e dobishme”. Ai mbërrin në përfundimin se një nga përbërësit kryesorë të pikëpamjes mbi “zgjuarsinë”, i shprehur nga fjala *akl*, nënkupton “etikën shpirtërore”.³⁶

Mprehtësia madje shkon përtej asaj që Guy Claxton e përca-
tkton si “d – mode” (mënyrë rrahje mendimi), një lloj zgjuarsie që ka lidhje me “kuptimin e çështjeve, peshimet pro dhe kundra, formulim arsyetimesh dhe zgjidhje problemesh, një lloj njohurie që varet në arsye dhe logjikë, ose mendim i matur ndërgjegjësues”. Vetë Glaxton tregon se rritja e pakënaqësisë me hamendësimin se rrahja e mendimeve është gjithçkaja dhe fundi i çdo aftësie njohëse, është pasqyruar në qasje të ndryshme brenda mundësive të cilat kanë të

36 Studimi i Karim Douglas Crow, *Between wisdom and reason: Aspects of 'Aql (Mind-Cognition) in Early Islam*, është botuar në *Islamica* 3:1 (verë 1999), fq. 49-64.

bëjnë me zgjuarsinë, siç janë: “zgjuarsitë e shumëfishta” të Howard Gardner dhe “zgjuarsia ndjesore” e Daniel Goleman.³⁷

Dikush mund t’u shtojë këtyre qasjeve të mundshme punimet e shkencëtarëve, si F. David Peat, i cili ka ndërthurur studimin e qenies njerëzore, historinë, gjuhësinë, parimet abstrakte, zhvillimin e gjithësisë, madje dhe teorinë kuantike, për të përshkruar mënyrën sipas së cilës pikëpamjet botërore dhe mësimet vendore të njerëzve tradicionale ndryshojnë bindshëm, në varësi të shikimit të botës, të ngulitura te ne nga shkenca njëdrejtimëshe perëndimore.³⁸

Për ta mbyllur, do sjell ndër mend librin e Harry Lewis, me titull: “Përsosmëri pa shpirt”, një hulumtim i fuqishëm mbi arsimin e lartë në Amerikë, nga vetë ish Dekani i Universitetit të Harvardit. Ky rishqyrtues shpall gjykimin e shumë dijetarëve dhe njohësve, se arsimit i lartë në Amerikë është në hall të madh. “Ndërtesat e universiteteve – pohon ai – janë shndërruar në ambiente festive dhe shumë njerëz fajësojnë vetë studentët, duke menduar se ata janë përtacë, të shtyrë drejt zbatimës dhe që nuk shqetësohen për asgjë tjetër, përveç vetes së tyre.”³⁹

Sipas Lewis, universitetet në Amerikë (duke përfshirë Harvardin) kanë harruar se detyra themelore e arsimit të lartë është t’i kthejë të rinjtë në të rritur, t’i ndihmojë ata të formohen, t’i mësojë se përse ekzistojnë, të hulumtojë për një qëllim më madhor në jetë dhe të largohen nga universiteti si qenie njerëzore më të mira. Lewis beson se kjo vjen ngaqë universitetet kanë dështuar në paraqitjen përpara studentëve të një arsyeje për t’u

37 Mbi këndvështrimet e Guy Claxton, rreth mënyrave të ndryshme të mendimit, shih punimin e tij *Hare Brain Tortoise Mind: Why Intelligence Increases When you Think Less* (London: Fourth Estate, 1997).

38 F. David Peat hulumton shkencën e racave vendore në librin e tij me titull: *Blackfoot Physics* (London: Fourth Estate, 1994).

39 Qëndrimi i Harry Lewis mbi humbjen e kuptimit, qëllimit dhe shtrirjes etike në arsimin bashkëkohor gjithëpërfshirës në Amerikë gjendet në librin e tij me titull: *America is in his Excellence Without A Soul: Does Liberal Education Have a Future?* (Public Affairs, 2007) dhe recensionin e cituar është nga Derek Melleby në CPYU (Center for Parent/Youth Understanding).

arsimuar, gjë që i detyron studentët të përballen me pyetje edhe më të thelluara, si kuptimi dhe qëllimi. Ata po dështojnë studentët dhe mbarë vendin të cilit dëshpërimisht i nevojiten qytetarë të mirarsimuar. Idesë së vjetër për një arsim të gjerë – shkruan ai – i ka ngelur vetëm emri. Tashmë, Harvardi nuk mëson gjëra të cilat do ta çlironin mendjen dhe shpirtin njerëzor”.

Le të qartësohemi në lidhje me gjendjen e Universitetit të Harvardit. Brenda tij ka dy shkolla që lëshojnë diploma universitare. I themeluar në vitin 1636, në Kembrixh, Masaçusets, është qendra më e vjetër e arsimit të lartë në Amerikë. Universiteti i Kembrixhit në Angli, i cili është themeluar në vitin 1209, sigurisht që është më i vjetër. Ende më i vjetër është Universiteti El-Kajravijn në Fes të Marokut, themeluar në vitin 859, i cili shpesh përmendet si universiteti i parë. Për vitin akademik 2014-2015, Harvardi u rendit i katërti në renditjen e Universiteteve Botërore dhe i dyti nga renditja e Times Higher Education, ndërkohë që Kembrixh u rendit i dyti dhe i pesti, përkatësisht. Universiteti më i mirë në të dyja renditjet ishte një Institut Teknologjie në Amerikë. Universiteti më i mirë në botën islame, sipas këtyre renditjeve, ishte Universiteti Malaya në vendin e 151-të dhe nuk pati asnjë universitet të botës arabe brenda 200 më të mirëve.⁴⁰

Të dhëna të tilla, shpeshherë bashkohen në ankesat rreth amullisë mendore dhe mungesës së prodhimtarisë së dijeve në botën islame, megjithëse ka pasur vërejtje të zëshme, por të drejta rreth vlerës së renditjes. Pa marrë parasysh këto vërejtje, renditjet janë masa të njohura gjerësisht për vlerësimin e cilësisë arsimore në nivelet universitare dhe një tregues i krizës së thellë brenda shoqërisë muslimane. Megjithatë, kritikata si ajo e Lewis, janë ndreqës të rëndësishëm të kapardisjes, sipas së cilës zgjidhja për arsimin në botën muslimane është riprodhimi pa kurrfarë shqyrtimi i modeleve perëndimore. Kjo do krijonte

40 Renditjen botërore të universiteteve për vitin 2014/15 e gjeni në: <http://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>.

përshtypjen se matësi kryesor i suksesit për të ecur para për institucionet e prapambetura muslimane, është përmirësimi në renditjen botërore, sipas sistemeve përcaktuese dhe kushteve ndërkombëtare. Një nga fuqitë e arsimit, është të na japë thellësi dhe gjerësi të përfytyrimit, që na mundëson të shohim se përparimi në dijet njerëzore nuk është rrugë njëkalimëshe. Nuk është tretja e një kulture apo botëkuptimi në një tjetër. Më saktë, është shkrirja e më të mirave që gjenden në çdo kulturë dhe qytetërim.

Arsimi duhet ta ketë fuqinë e synimit drejt një pikëpamjeje të përgjithshme mbi përsosmërinë që përfshin të vërtetën, kuptimin, qëllimin dhe çfarëdo që duhet për të qenë plotësisht njeri.

“Dituria është fuqi” – është një thënie e cila zakonisht i mvishet një filozofi dhe shkencëtari të njohur anglez të vitit 1597, që ende sot e kësaj dite vë në pah rëndësinë e dijes në botën bashkëkohore. Arsimi krijon themelet e dijes sonë dhe të zhvillimit të saj, që nga përvojat tona më të hershme shkolllore e deri në arsimin e mesëm. Njerëzit e përdorin diturinë në jetën e tyre profesionale e vetjake dhe shoqëria, si bashkësi njerëzish, i jep trajtë botës në të cilën jetojmë. Ndaj dhe fuqia e arsimit është një nga çelësat e zhvillimit të një shoqërie të suksesshme, që i jep dobi gjithë njerëzimit. Mirëpo gjërat kanë rrjedhur fare keq. Shoqëria, vlerat dhe morali, që të tria kanë shkuar duke u bjerrë. Si mund ta ketë humbur arsimi fuqinë e tij për të ndërtuar një shoqëri të dobishme dhe të drejtë?! Si mund të ndalohet kjo rënie?!

Te *Fuqia e Arsimit*, autori u rikthehet parimeve fillestare dhe pyet: çfarë është arsimi, çfarë kërkon gjithsecili dhe shoqëria në tërësi prej arsimit? Rilidhja e arsimit me “zemrën dhe shpirtin” e njerëzimit si dhe gjetja e qëllimit madhështor të njeriut është e një rëndësie parësore. Kjo ndryshon nga “fabrika e dijes”, e cila thjesht zhvillon njerëz për përparim material e zhvillim vetjak. Vlerat, morali, dhembshuria, ndjeshmëria, mirënjohja, respekti i ndërsjellë, ndershmëria dhe përgjegjësia shoqërore, janë që të gjitha veçori thelbësore për njerëzit, të cilat, të marra në tërësi krijojnë një shoqëri të suksesshme. Këto tipare kanë nevojë të rrenjosen përgjatë gjithë përvojës arsimore. Duke rimenduar dhe zhvilluar një mënyrë të dobishme arsimit, njeriu mund të vazhdojë të punojë për ndërtimin e një bote më të mirë, e mbështetur në barazi dhe drejtësi për të gjithë.



JEREMY HENZELL-THOMAS është bashkëpunëtor shkencor (dhe ish-bashkëpunëtor i jashtëm) në Qendrën e Studimeve Islame, në Universitetin e Kembrixhit. Bashkëpunëtor i Shoqërisë Mbretërore të Arteve dhe anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Muslimane të Shkencave Shoqërore (AMSS UK). Ai ka qenë i pari Kryetar i Forumit Kundër Islamofobisë dhe Racizmit (FAIR), si dhe është themeluesi dhe ish-Drejtori Ekzekutiv i *Fondacionit Libri*. Tashmë është bashkëpunëtor i redaksisë së *Critical Muslim*, gjithashtu ka shkruar rregullisht ndër vite për revistat *Islamica* dhe *Emel*, përpos rubrikës Besimi në gazetën *The Times*. Si ish-mësimdhënës në Gjuhësi të Zbatuar, pranë Universitetit të Edinburgut, përpiqet t'i ushtrojë aftësitë e tij akademike të filologjisë dhe psiko-gjuhësisë, në çështjet bashkëkohore që ndikojnë në përshtypjen rreth Islamit dhe muslimanëve, si dhe në përparimin e dialogut dhe bashkëbisedimit kritik, në një sërë këndvështrimesh shoqërore, kulturore dhe arsimore.



ISBN 978-9928-126-30-6

